



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2020:003636
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05749149

K.DH.SH.II.nr.989/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit “: I.v.a.s Industria Vernici S.p.a, me seli ne Itali, me nr. të biznesit 00124120403, aksionar me 19% në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k dhe M.H., me nr. personal ..., me vendbanim në Vushtrri, aksionar me 41% në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokat Agron Selimaj me seli të zyrës në Prishtinë, kundër kundërshtarëve të masës së sigurimit: A.H. me nr. personal ..., me vendbanim ne Mitrovicë dhe V.H. me nr. personal, me vendbanim ne Mitrovicë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokat Korab Sejdiu me seli të zyrës në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së kundër propozuesit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.878/2023, të datës 24.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e kundër propozuesit të sigurimit, A.H. me nr. personal ..., me vendbanim ne Mitrovicë aksionar në Shoqërinë Tregtare Eco-Color Sh.p.k., me seli në Prishtinë, ndërsa **NDRYSHOHET** Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr.878/2023, të datës 24.11.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar propozimi i propozuesve të masës së sigurimit: I.v.a.s Industria Vernici S.p.a, me seli ne Itali, me nr. të biznesit 00124120403, aksionar me 19% në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k dhe M.H., me nr. personal ..., me vendbanim në Vushtrri, aksionar me 41% në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k, me të cilën kanë kërkuar të caktohet masa e sigurimit ashtu që ti ndalohe të paditurave/ kundërshtareve të sigurimit A.H. me nr. personal ..., me vendbanim ne Mitrovicë dhe V.H. me nr. personal, me vendbanim ne Mitrovicë dhe personave të tretë të pa autorizuar të shoqërisë Tregtare “Eco Color” SH.P.K me seli në adresën Rr.Epiri nr.11 në Mitrovicë të qasen/hyjnë në pronën, zyrat, hapsirat dhe objektin e shoqërisë tregtare “Eco Color” SH.P.K me seli në adrës rr. Epirit nr.11, në Mitrovicë.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të aprovohe në tërësi si i bazuar propozimi i propozuesve të masës së sigurimit: I.v.a.s Industria Vernici S.p.a, me seli ne Itali, me nr. të biznesit 00124120403, aksionar me 19% në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k dhe M.H., me nr. personal ..., me vendbanim në Vushtrri, aksionar me 41% në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k, dhe CAKTOHET masa e sigurimit ashtu që i ndalohe të paditurave/ kundërshtareve të sigurimit A.H. me nr. personal ..., me vendbanim ne Mitrovicë dhe V.H. me nr. personal, me vendbanim ne Mitrovicë dhe personave të tret të pa autorizuar të shoqërisë Tregtare “Eco Color” SH.P.K me seli në adresën Rr.Epiri nr.11 në Mitrovicë të qasen/hyjnë në pronën, zyrat, hapsirat dhe objektin e shoqërisë tregtare “Eco Color” SH.P.K me seli në adrës rr. Epirit nr.11, në Mitrovicë. II. Kjo masë e sigurimit vlen deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë kundërshtari i sigurimit A.H. me nr. personal ..., me vendbanim ne Mitrovicë dhe V.H. me nr. personal, me vendbanim ne Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, më propozim qe Dhoma e Shkallës së Dytë pas shqyrtimit të pretendimeve akimore, ta aprovoje si të themeltë ankesën dhe ta Ndryshojë Aktvendimin e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pak propozuese.

Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktvendimit të atakuar dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 194 në lidhje me nenin 208 të LPK-së, Dhoma e Shkallës së Dytë ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i masës së sigurimit “I.v.a.s Industria Vernici S.p.a, me seli ne Itali, me nr. të biznesit 00124120403, aksionar me 19% në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k dhe M.H., me nr. personal ..., me vendbanim në Vushtrri, aksionar me 41% në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k, ka propozuar që t’iu ndalohet kundërshtarëve të sigurimit V.H. dhe A.H. ashtu që i ndalohet të paditurave/ kundërshtarëve të sigurimit A.H. me nr. personal ..., me vendbanim ne Mitrovicë dhe V.H. me nr. personal, me vendbanim ne Mitrovicë dhe personave të tretë të pa autorizuar të shoqërisë Tregtare “Eco Color” SH.P.K me seli në adresën Rr.Epiri nr.11 në Mitrovicë të qasen/hyjnë në pronën, zyrat, hapsirat dhe objektin e shoqërisë tregtare “Eco Color” SH.P.K me seli në adrës rr. Epirit nr.11, në Mitrovicë

Gjykata e shkallës së parë konsideron se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, që të caktohet masa e sigurimit, sepse në rastin konkret propozuesit e kanë bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive sepse nga provat e paraqitura në shkresat e lëndës bëhet e besueshme se propozuesit I.v.a.s Industria Vernici S.p.a, me seli në Itali, me nr. të biznesit 00124120403, kanë në pronësi 19% të aksioneve në ndërmarrjen Eco-Color Sh.p.k dhe M.H., me nr. personal ..., me vendbanim në Vushtrri, si aksionar ka në pronësi 41% të aksioneve në ndërmarrjen Eco-Color të shoqërisë në bazë të së cilës ka të drejtën e kualifikuar në vendimmarrje dhe mund të disponojë me të drejtat që janë të përfaqësuara në aksion konform nenit 3 par.1.2. të Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare (LSHT).

Gjykata vlerësoi se pretendimet e propozuesve janë të qëndrueshme dhe të bazuara në ligj, sepse kundërpropozuesi si aksionar minoritar me 37 % të aksioneve ndërpre në veprimtarin afariste të Shoqërisë Eco Color dhe merr në mënyrë të kundërligjshëm kompetencat e Kuvendit të Aksionarëve të paraparë me dispozitat e nenit 102,105 dhe 108 të LSHT-së, me të cilët thuhet citoj: Sipas nenit 102 të LSHT-së, Kuvendi i Aksionarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

Bazuar në dispozitat e sipërcituara rezulton se veprimet e ndërmarra nga kundërshtarët e masës së sigurimit si Aksionarë minoritar në Shoqërinë Tregtare “Eco Color ” SH.P.K., janë veprime kundërligjore të marra nga një aksionar i shoqërisë tregtare, dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore dhe statutore të shoqërisë.

Gjykata në shkallë të parë ka shtuar që fakti se kundërshtarët e sigurimit nuk pajtohen që të zbatoj procedurat që aplikohen nga Kuvendi t’i aksionarëve, është jo relevant nga shkak se pjesëmarrja në përqindjen e aksioneve përcakton edhe vëllimin e të drejtave të aksionarit, prandaj fakti se kundërshtarët e sigurimit janë aksionar të 37% të aksioneve, nuk nënkupton të drejta të pakufizuara mbi tërë shoqërinë por të drejta të kufizuara në proporcion me pjesëmarrjen në aksione dhe gjithmonë duke respektuar dhe ndjekura procedurat dhe vendimet e organeve të shoqërisë, të marra nga shumica e aksionarëve. Përqindja e aksioneve përcakton fuqinë vendimmarrëse dhe vullneti i shumicës i shndërruar që duhet të shndërrohen në vendim të Kuvendit të Aksionarëve, si organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë tregtare, përbën vendim të tërësisë së aksioneve respektivisht vendim të shoqërisë tregtare dhe detyron të gjithë aksionarët përfshirë edhe aksionarët të cilët nuk pajtohen me këto vendime. Me vet faktin e pranimit e të qenit aksionar minoritar në shoqëri tregtare nënkuptohet edhe pranimi i vendimeve të kuvendit të marra nga shumica e aksionarëve sipas parimit “një aksion një votë”.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, por gjendja faktike dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së dhomës së shkallës së parë.

Sipas Nenit 8.2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërgjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku për të ardhur te e vërteta materiale. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar si të bazuar propozimin e palëve propozuese për caktimin e masës siguroese, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht

pa i vërtetuar me prova konkrete faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktvendimit të atakuar nuk është e qartë se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi se propozimi i palës propozuese për caktimin e masës siguroese është i bazuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar fare nëse janë plotësuar kushtet nga Neni 297 par.1 i LPK-së, por në tërë arsyetimin e aktvendimit të atakuar vetëm është referuar ne dispozitat e Nenit 297 par. 1 pika a) dhe b) të LPK-së, por nuk është dhënë asnjë fakt i vërtetuar dhe asnjë arsye pse gjykata ka konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës siguroese.

Sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.* Ne rastin konkret gjykata e shkallës së parë është mjaftuar me theksimin se Kuvendi i Aksionarëve në bazë të autorizimeve statusore dhe ligjore ka të drejtën e plotë të marrë vendime për mënyrën e menaxhimit të shoqërisë dhe zhvillimin e aktivitetit afarist, për të cilat kundërshtarët e sigurimit me veprimet e tij po i pamundëson të zbatohen. Kundërshtarët e sigurimit, me veprimeve e tyre po e pengojnë ushtrimin e kompetencave të organeve të autorizuara të shoqërisë dhe këto veprime mund të ndikojnë në përkeqësimin e aktivitetit afarist dhe gjendjes financiare të shoqërisë.

Nga arsyet e paraqitura më lartë gjykata vlerëson se shkaqet dhe pretendimet mbi të cilat në rastin konkret është kërkuar që të vendoset masa e sigurimit janë bërë të besueshme dhe janë të bazuara, nga fakti se propozuesi ka arritur ti tregoj faktet në të cilat mbështetet kërkesa e tij si dhe i ka ofruar prova të besueshme gjykatës se në rast se masa e sigurimit nuk caktohet, ai do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme dhe si rrjedhojë gjykata vendosi të aprovoj propozimin për caktimin e masës së sigurimit meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 pika a) dhe b) të LPK-së.

Ky citim i kushteve të përcaktuara me dispozitën e Nenit 297.1 nën pika b) të LPK-së, dhe parashikimi i mundësisë pa dhënë asnjë fakt apo rrethane e cila do të ndikonte që kundërshtari i sigurimit të ndërmerre veprime me të cilat do të plotësoheshin kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit dhe pa argumentuar se propozuesi ka pengesa reale për realizimin e të drejtave të tij, nuk përbën arsyetim ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 160. pika 4, e cila thekson se arsyetimi duhet të përmbajë: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato, e në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me theksimin në mënyrë të përgjithësuar të kushteve ligjore.

Poashtu nga arsyetimi nuk është e qartë se në bazë të cilave prova ka përcaktuar besuesmërinë e ekzistimit të kërkesës së propozuesit. Mundësia e shkaktimit të vështirësive në realizimin e kërkesës së palës tjetër në raportet juridiko-civile, ekziston gjithmonë dhe është karakteristike përcjellëse e raporteve juridike por kjo kurrsesi nuk do të thotë që me vetë krijimin e raportit të caktuar juridik me automatizëm krijohet baza ligjore për caktimin e masës së sigurimit por duhet të plotësohen edhe kushtet ligjore të përcaktuara me Nenin 297.1 nën pika a) dhe b) të LPK-së, respektivisht besueshmëria e ekzistimit të kërkesës dhe ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, e të cilat duhet të vërtetohen me prova konkrete.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se provimi i fakteve varësisht prej llojit dhe natyrës së faktit është detyrë e palëve si dhe e gjykatës. Gjatë procedurës gjyqësore objekt i të provuarit duhet të jenë të gjitha faktet relevante të cilat janë me ndikim në vendosjen e çështjes. Gjykata ka për detyrë që gjendja faktike të vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe në këtë drejtim duhet të kujdeset që të administrohen të gjitha faktet të cilat janë thelbësore për epilogun e kontestit.

Gjykata e shkallës së dytë gjeti se kërkesat nga propozimi nuk rezultojnë të jenë vendime që i takojnë Organeve të shoqërisë dhe nuk mund të kërkohet nga gjykata përcaktimi i personave përgjegjës dhe autorizimeve të tyre në drejtimin e shoqërisë, e aq më tepër t'i ndalohej pronarëve të shoqërisë, pavarësisht pjesëmarrjes së tyre në aksione, qasja në shoqërinë ku janë bashkëpronar sepse kjo do të përbente shkelje të së drejtave pronësore absolute të tyre. Madje lënia e shoqërisë pa Drejtor menaxhues përderisa Kuvendi i Aksionarëve si Organ i autorizuar

nuk ka vendos për zëvendësimin e tij, do ta përkeqësonte gjendjen financiare të shoqërisë e me këtë edhe do të rrezikonte më shumë realizimin e kërkesave të propozuesve, nëse këto kërkesa rezultojnë si të bazuara.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që ankesa të aprovohet dhe aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, duke refuzuar propozimin për caktimin e masës siguruese.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr. 989/24, me datë 28.05.2024

Kryetarja e kolegjit - Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti